REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 732/20
Datë/Datum. 16.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ilaz Papaj-Ekspert Shqyrtues	*Data e autorizimit të ekspertit 07.10.2020*	*Data e dorëzimit të raportit 16.10.2020*	Nr. i lëndës: *732/20*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 30.09.2020, OE "Olti Trasing"Shpk - Prishtinë,ka parashtruar ankesë me nr. 732/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë, OE "Alba Konstruksion" Shpk,Tiranë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i sheshit Adem Preniqi"** ,me nr.prokurimi 614-20-3884-5-1-1 ,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"KK Obiliq"
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**,lloji i kontratës:**Punë**,vlera e parashikuar e kontratës: **1,398,297.28 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- **Neni 1 i LPP-së**
- **Neni 6 i LPP- së**
- **Neni 7 i LPP-së**
- **Neni 59 i LPP-së**
- **Neni 60 i LPP-së**
- **Neni 40 i RRUOPP-së**
- **Neni 41 i RRUOPP-së**

- Është shkelur neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publi Nr.04/L-042 (Barazia në trajtim-Jo diskriminimi),i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92.
- Është shkelur neni 72 i Ligjit të Prokurimit Publi Nr.04/L-042 (Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë),i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92.

Neni 72
Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Në letër standarde për tenderuesin e eleminuar të datës 06/09/2020 në sqarim shkruan: "X Nuk keni përmbushur Kërkesat mbi kapacitetin ekonomik financiar dhe kërkesat mbi mundësite teknike dhe/ose profesionale"-

Edhe pse në njofimin për kontratë Pika IV.2) Kriteret e Dhënies dhe në dosjen e tenderit kriter për dhënien e kontratës ka qenë:Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët ju keni shpërblyer ofertën e operatorit Alba Konstruksion,Shqipëri,1001 Tiranë për një shumë 989,026.00 € -(minus) shuma e ofertës tonë 914,544.43=74,448.44 € për këtë shumë ju e keni dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës.

Në letër standarde për tenderuesin-kandidatin e eleminuar në

ARSYETIM keni shënuar:

"Të pjesa kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale si në FDT sipas nenit 9.1&9.2 kërkesanr 1.Kapaciteti teknik dhe profesional.

Operatori Ekonomik (OE) në listën e projekteve të realizuara si dhe tek dëshmitë e ofruara NUK ka paraqitur referenca,punë të natyrës së njejtë për periudhën e shkuar 3 vjeçare,shuma e paraqitur për kryerjen e punëve të njejta nuk i përmbushë kërkesat sipas FDT neni 9.1&9.2,prandaj Operatori Ekonomik nuk i plotëson Kërkesat mbi mundësite teknike dhe/ose profesionale".

Përgjigjie oferta e Operatorit ekonomik (OE "Olti Trasing"Sheshi Bill Klinton,10000 Prishtinë është e përgjegjshme që i plotëson të gjitha kriteret e shënuara në njoftimin për kontratë dhe në dokumentet të cilat e përbëjne dosjen e tenderit.Jo që i plotëson,por e tejkalon shumë fish shumën të cilën ju e keni kërkuar FDT nenin 9.1&9.2.
Çdo objekt i ndërtuar qoftë afarist apo banesor sipërfaqe të mëdha ka ndërtime të shesheve e ndërtime të tilla kemi mjaft shumë sa që ndoshta po të kishim pasë mundësi t'i ndajmë do e kalonim shumën e planifikuar për ndërtimin e sheshit e jo vetëm 1,000,000.00 € ashtu siç keni kërkuar ju,dhe të gjitha ndërtimet janë përafërsisht të njejta.
Provë:
Aneksi 6. Kriteret për dhënie të kontratës,përkatësisht kista e kontratave të realizuara për periudhën e kërkuar.

Në përfundim të prezentimit të argumenteve përmes kësaj Ankese kërkojmë nga eksperti shqyrtues i OSHP-së që

t'i propozoi Panelit Shqyrtues të OSHP-së të aprovojnë Ankesën e Operatorit Ekonomik "Olti Trasing"Shpk-Sheshi Bill Klinton,pn Prishtinë,Rep. e Kosovës,dhe i tërë aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim dhe të urdhërohet autoriteti kontraktues Komuna e Obiliqit-Departamenti i Prokurimit të bie këtë:

VENDIM

-MIRATOHET si e bazuar Kërkesa për rishqrti e Operatorit Ekonomik"Olti Trasing" Shpk -Sheshi Bill Klinton,pn Prishtinë.

-ANULOHET Vendimi përkatësisht Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues –shpërblim me kontratë i publikuar në ëeb faqen e platëformës elektronike të KRPP-së me datë 16/09/2020.

-Të mirren amsa adekuate korrigjuese për eleminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendosët që me kontratë publike për aktivitetin e lartëcekur të prokurimit të shperblehetoferta e operatorit ekonomik "Olti Trasing" Shpk, Sheshi Bill Klinton,pn Prishtinë,si ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët që plotëson të gjitha kriteret e specifikuara në Njoftimin për Kontratë dhe në dokumentet të cilat e përbëjne dosjen e tenderit.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1. *Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë në (3) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) jo me pak se;1,000,000.00 €. Në rast të grupit Lideri duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të natyrës së njëjtë*

Dëshmia 1. *Lista e kontratave të realizuara,sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 6, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerjen e punëve.*

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni i vlerësimit ne raportin e tyre të datës 16.09.2020 pas ekzaminimit të ofertave ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE "Alba Konstruksion"Shpk - Tiranë me çmim prej 989.026.00 €.

Sa i përket ofertës së OE ankues "Olti Trasing"Shpk – Prishtinë,nga komisioni i vlerësimit kjo ofertë (edhe pse ofertë më e lirë 914, 577.56 €) është shpallur e papërgjegjshme me arsyetimin se nuk përmbush kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar kontrata dhe referenca të realizuara për periudhen tre vjeqare jo më pak se 1.000.000.00 €.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "OLTI TRASING"SHPK -PRISHTINË

Përgjigje në Pretendimin 1

Lidhur me pretendimin e OE ankues"Olti Trasing"Shpk - Prishtinë.se AK gjatë vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk përmbush kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar kontrata të natyrës së njejtë në tri vitet e fundit jo më pak se 1,000,000.00 €, që sipas OE ankues kontratat dhe referencat e dorëzuara e tejkalojnë këtë vlerë dhe AK gjatë vlerësimit të tenderëve ka bërë shkelje të nenit 1,6,7,59,60 të LPP-së,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderti tek kërkesa 1. e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë në (3) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) jo me pak se:1,000,000.00 €. Në rast të grupit Lideri duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të natyrës së njëjtë,e dëshmuar me listën e kontratave të realizuara,sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 6, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose çertifikatat për kryerjen e punëve.

OE ankues"Olti Trasing"Shpk se bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar edhe listën e kontratave të realizuara konform Aneksit 6.të dosjes së tenderit të dëshmuara me kontrata dhe referenca për realizimin e tyre.

OE ankues"Olti Trasing "Shpk ka dorëzuar kontratën e lidhur me Komunën e Lipjanit për"Ndërtimi i sheshit Adem Jashari" e lidhur me datë 11.10.2016 me nr prokurimi 613-016-069-5-1-1 në vlerë prej 465,757.77 €. Gjithashtu është dorëzuar edhe çertifikata e pranimit të punimeve e datës 05.12.2018 që është konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Gjithashtu OE "Olti Trasing"Shpk ka dorëzuar edhe kontratën dhe aneks kontratën me Ministrine e Administratës Publike për "Ndërtimi i ndërtesës së IKAP Lot 10" e lidhur me 14.11.2016 në vlerë prej 1,643,051.43 € dhe 38,022.36 € për ankes kontratën.OE ankues ka bashkangjitur edhe referencën për realizimin e punimeve të datës 13.03.2020.
Eksperti shqyrtues sqaron se kjo kontratë dhe referenca për realimizin e kësaj kontrate e prezentuar nga OE ankues duhet të konsiderohet e natyres së njejte përshkak se paramasa/pozicionet për punët që do të kryhen në aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i sheshit Adem Preniqi" siç janë pozicionet e instalimeve elektrike, instalimet e ujit,punët e betonit,gjelbrimit,ndërtimi i mureve,vendosja e kubëzave/pllakave,etj janë të natyrës së njejtë me pozicionet/punët që janë realizuar në kontratën e prezentuar nga OE ankues,andaj sipas ekspertit shqyrtues kjo kontrate dhe disa kontrata tjera të punëve të prezentuara nga OE ankues janë konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe përmbushin vlerën e kërkuar prej 1,000,000.00 €.

Pretendimi ankimor është i bazuar

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet si e bazuar**.të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim.**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KK OBILIQ
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – "OLTI TRASING"SHPK"